

R E P U B L I K A E K O S O V Ë S

/REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO /

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË / OSNOVNI SUD U MITROVICI / BASIC COURT IN MITROVICA

C.nr.76/2009

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshljen juridike te paditesese: nga - Komuna e Mitrovices te cilen e perfaqson Avokat; nga Mitrovica sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditures; ne Prishtine te cilen e perfaqsojne; dhe sipas autorizimeve me shkrim, baza e kontestit ; ndryshimi i vendimit per mbajtjen e humbur-rentes, vlere e kontestit; 14.833,82 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.12.11.2013, jep kete;

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** kerkespadia e paditeses nga Komuna e Mitrovices dhe **DETYROHET**e paditura ne emer te rentes paditeses ti paguaj shumen prej **309,72 Euro** duke filluar nga dt. **01.07.2013** e deri sa per kete te ekzistojne kushtet ligjore dhe ate me se largu gjer me dt. 05 te muajit vijues. Ndersa ne emer te rentes se papaguar per periudhen **01.07.2009** e deri me **31.06.2013** ti paguaje shumen prej **14.833,82 Euro**, te gjitha keto ne afarin prej 15 diteve nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi nene kerencim te ekzekutimit te dhunshem.

Obligohet e paditura qe paditeses ti kompenzoje shpenzimet e procedures kontestimore ne shume prej 949,38 Euro, ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi.

**A r s y e t i m**

Paditesja ne padi si dhe nepermjet te autorizuarit te saje ne seancat e mbajtura ka theksuar se me aktgjykimin e plotfuqishem ne baze te pranimit C. nr. 61/2000 dt. 30.05.2003 eshte obliguar e paditura qe paditesve te iu paguaj ne emer te mbajtjes se humbur-rentes shumen mujore prej 148 Euro duke filluar nga 01.04.2003 derisa per kete te ekzistojne kushtet ligjore .

Duke patur parasysh faktin se nga dt. e caktimit te kesaje rente kane kaluar shume vite, ndrsa paditesit nuk kane kerkuar ndryshimin e te njejtës, ndersa ne nderkohe jane ndryshuar rrethanat dhe kushtet jetsore dhe ate disa here jeta eshte ma e shtrejte , ndrsa edhe te ardhurat personale te mbajtsit te familjes se tyre po te ishte ne jete dhe pune do te ishin shume me te larta, andaj i njejtë do te kontribonte me shume ne mbajtjen e paditesve sikurse te ishte gjalle.

I autorizuari i paditeses pase ekspertizes nga lemia financiare , beri precizimin e kerkespadise sikurse ne dispozitivin e ketije aktgjykimi, duke i propozuar gjykates qe ta aprovoi ne tersi si te bazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore i kerkoi.

I autorizuari i te paditures ne seancen e shqyrtimit kryesore ne fjalen perfundimtare , nuk e kontestoi bazen e kerkespadise ndrsa e konteston lartsine e saje duke theksuar se me rastin e caktimit te rentes per paditesen nga ana e ekspertit financiar eshte teper e larte e sidomose sa i perkete lartesis se pcreaktuar per shpenzimet vetanake sikurse i ndjeri te ishte gjalle qe ajo shume – lartesi ne praktike dhe parim do te ishte 30%, e jo 25%, sikurse ka theksuar eksperti dhe se i njejt ka pasur per detyre te beje llogaritjen e difernces nga pensioni familjar te cilin do ta realizonte paditesi dhe ndryshimi munde ti vihet ne barre tani te paditures, ngase renta eshte diferenca ne mese te ardhurave te realizuara sipas bazes se pensionit dhe te ardhurave qe do ti realizonte ne marrdhenje pune.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Aktgjykimin e kesaje gjykate C. nr. 60/2000 dt. 30.05.2003, Vertetimin e Qendres Regjionale te Punsimit ne Mitrovice nr. 324/12 dt 17.12.2012, Vertetimi i Qendra rajonale e administratesn pensionale ne Mitrovice nr 2654 dt 20.12.2012, si dhe ekspertizen e ekspertit financiar ; dt. 03.06.2013 si dhe ndegjoi ekspertin ne fjale dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga palet ndergjygjese gjykata konstatoi se nuk ishte kontestuese baza e kerkespadise por kontestuese ishte lartesia e te njejtës.

Nga ekspertiza financiare e ekspertit . , ecc i dipl., konstatohet se llogaritja e rentes se papaguar per periudhen [01.07.2009 gjer 31.05.2013] eshte ne shume preje 14.524,10 Euro, ndersa renta mujore per periudhen prej dt. 01.06.2013 e deri sa te egzistojne kushtet ligjore eshte 309,72 Euro per familjen e te ndjerit

Eksperti ne fjale ne seancen e shqyrtimit kryesor ne lidhje me kundershtimet e pales se paditur sa i perket lartsise se rentes deklaroi; mbetet ne tersi pran ekspertizes se dhene me shkrim duke spjeguar se llogaritjen e rentes e ka bere ne baze te kualifikimit te cilin e ka poseduar i ndjeri deri sa ka punu ne “Trepce” dhe mesataren e pagave ta realizuara te realizuara ne Kombinatin “Trepca”, qka ne lende gjendet vertetimi per kualifikimin e te ndjerit dhe vertetimi mbi ecurit e pagave per kete periudhe kohore te llogaritur. Ndersa shpenzimet personale jane llogaritur 25%, ne baze te kriteriumeve ekonomike qe konsiderohet si praktik reale per shpenzimet personale qe punon, kurse



75%, te pages mbeten si bugjet per familje. Renta paraqet fitimin e humbur i cili ne kete rast i ndjeri kishte me i realizu po te ishte gjalle. Kjo llogaritje e rentes nuk ka te beje me numer te antarve te familjes por vetem paraqet bazen themelore- paga mesatare te cilen e ka realizuar deri sa ka qene gjalle.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte , gjykata kerkespadin e paditeses e aprovoi ne tersi si te bazuar, nga se tani kane ndryshur ne menyre te konsiderushme rrethanat te cilat gjykata i ka pasur parasyshe me rastin e nxjerrjes se vendimit te meparshem, konform nen. 155, 172.1 dhe 2, nen 176 dhe 180 te Ligjit mbi marrdheniet detyrimore, [Ligji nr. 04/L-077], Gaz.zyrt e RK, nr.16 dt.19.06.2012, duke i njohur paditeses ne emer te mbajtjes se humbur -rentes mujore si ne dispozitiv te ketije aktgjykimi e duke llogaritur lartsin e rentes per periudhen e cekur si ne dispozitiv.

Gjykata konsideron se paditesja ka pasur cenim te rend te personalitetit te saje ne marrdhenjet dhe interesat familjare ne aspektin pasuror me rastin e vdekjes se ish bashkshortit te saje. Prandaj paditesja me te drejte kerkon rikthimin e gjendjes parpara fatkeqsise, sikur vdekja e te ndjerit te mose kishte ndodhur, duke e detyruar te padituren ti demshperblej humbjet pasurore nga paksimi i te ardhurave ne familje si mbeshtetje ekonomike e tije per familjen ne te ardhmen.

Gjykata vlersoi prapsimet e te paditures dhe si te tilla i konsideron si te pabazuara nga se eksperti ne fjale me rastin e caktimit te lartesis se rentes tani lendore ne menyre te hollshisme, bazuar dhe profesionale ka spjeguar ecurin dhe llogaritjen e saje , qka nje konstatim te till gjykata e akceptoi ne tersi si te drejte ,te bazuar dhe te dhene ne harmoni me kriteret dhe natyren per kete ekspertize financiare.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore , bazohet ne baze te nen. 450., 452.1 nen 453.2 te LPK, si dhe nen. 6 -Tarifes se Avokatve dhe nen, 10,1 dhe 12 te Tarifes mbi Taksat gjyqsore, duke i njohur paditeses; per perpilimin e padis shumen prej 135,00 Euro, per pjesmarrje ne 4 seanca nga i autorizuari i saje shumen prej nga 121,68 Euro, per ekspertiz financiare shumen perej 153,30 Euro, si dhe takasat per padi dhe aktgjykim shumen prej 175,20 Euro.

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitiv te ketije aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE  
C.nr.756/2009 dt. 12.11.2013.

**Gjyqtari,**  
Ragip Kadriu

**KESHILLE JURIDIKE:** Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit te Kosoves ne Prishtine e permes kesaje gjykate.